



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SEKTORI JURIDIK

Nr. 194 prot.

Tiranë, më 04.02 2019

URDHËR

Nr. 20, datë 04.02 2019

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË URDHRIN E REKTORIT NR. 50, DATË 03.12.2018 MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BËRSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE ( I NDRYSHUAR)”**

Në zbatim të nenit 112 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; pikës 3, të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 1 dhe 5 të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010 për “Mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”; të nenit 2, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.06.2008 për “Zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës” (i ndryshuar); nenit 6 të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 për “Statusin e jetimit” (i ndryshuar); nenit 8 të ligjit nr. 8098 datë 28.03.1996 për “Statusin e të verbrit”(i ndryshuar); nenit 8 të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 për “Statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); nenit 12 të ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993 për “Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist” (i ndryshuar); nenit 32 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore”(i ndryshuar) dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar),

URDHËROJ:

1. Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 23.01.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet e studimit në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, kriteret për fitimin e bursës nga studentët e UART janë, si më poshtë vijon:
  - a. studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përlogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë:

- i) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;
- ii) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

- b. Studentët e regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të vitit paraardhës akademik të përlogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.
- c. studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;
- d. bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;
- e. studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;
- f. studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;
- g. studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;
- h. studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;
- i. studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
- j. studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;
- k. studentët që janë identifikuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;





1. studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
2. Pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përfitojnë bursë, për vitin akademik 2018-2019, sipas formularit bashkëlidhur këtij urdhri, vetëm në zbatim të kriterëve të sipërcituara në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Afati i dorëzimit të aplikimeve nga ana e studentëve është deri në datën 18 Shkurt 2019, pranë zyrës së Drejtorisë Ekonomike në Rektorat.
4. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, grupi i punës i ngritur me urdhrin e Rektorit nr.50, Drejtorja Ekonomike, Dekanët dhe K/Sekretaritetë e Fakulteteve pranë Universitetit të Arteve.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë**

**Prof. Kastriot Caushi**

**REKTOR**  
**UNIVERSITETI I ARTEVE**